Shtojca 2 :
Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Integrimin Evropian

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 10 datë 20/ 06/ 2025

Nr__1__Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË ZBATIM TË PROJEKTIT: TREGUESI I KOMUNITETIT PËR INVESTIME NË VLERË DHE KAPACITETE INOVACIONI" NE KUADER TE PROGRAMIT "IPA ADRION FINANCUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015, te miratuar me date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.5/, 14, 54, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne Republiken e Shqiperise", ligjin Nr.43/2016, te miratuar me date 21.04.2016 "Per marreveshjet nderkombetare ne Republiken e Shqiperise", neni 4, ligjin Nr.21/208, te miratuar me date 12.04.2018 "Per Ratifikimin e marrëveshjes se financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Europian për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (ADRION) 2014-2020", ligjin Nr.37/2015, te miratuar me date 09.04.2015 "Per Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ligjin Nr.138/2016, te miratuar me date 22.12.2016 "Per Ratifikimin e marrëveshjes se financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Itali–Shqipëri–Mali i Zi, 2014–2020", i propozoj Keshillit Bashkiak Has, të:

Situata aktuale e funksionit Programi Interreg V-B Adriatik-Jon (më poshtë referuar si ADRION), ngritur në kuadër të Bashkëpunimit Territorial Europian (ETC) - politikat e kohezionit - një nga objektivat përfshin 31 rajone nga katër shtete partnere të ndryshme ERDF dhe katër shtete partnere IPA

Objektivi i përgjithshëm i Programit ADRION është të veprojë si një drejtues energjik i politikave dhe novator i qeverisjes që nxit integrimin europian ndërmjet shteteve partnere si (***Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia)***, duke përfituar nga burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore përreth deteve Adriatik dhe Jon dhe rritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial në zonën e Programit.

Programi ADRION mund të ofrojë kornizën optimale për koordinimin e veprimeve të tilla dhe të mbështesë zhvillimin e strategjive transnacionale për promovimin së bashku të rajonit si një destinacion turistik

Gjithë zona e bashkëpunimit, te perfshire ne kete program, ka potencial të lartë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit kulturor në qytetet kryesore, dhe të turizmit të qëndrueshëm në lidhje me pasuritë mjedisore.

SFIDAT

Burimet publike për bashkite e vogla rurale dhe malore rrezikojnë të humbasin efektivitetin e tyre nëse nuk nxisin investimet private. Për më tepër, burimet publike nuk përdoren gjithmonë në mënyrë efektive për të zgjidhur problemet sociale dhe ndryshimet demografike (plakjen dhe shpopullimin e banorëve). Investitorët publikë dhe privatë kanë nevojë për siguri. Bashkite e vogla gjithashtu duhet të mësojnë mënyra për të ndryshuar aftësinë e tyre për të tërhequr investime (dialog me administratat rajonale, rritje të transparencës dhe aksesueshmërisë, shërbime bazë dhe cilësi të jetës, atraktivitet të identitetit kulturoro-mjedisor, treg dhe hapësirë të pasurive të paluajtshme, por mbi të gjitha dinamizëm lokal dhe 'kapital social'1)

(1) Komisioni Evropian po punon per : (Zhvillimin lokal te udhëhequr nga komuniteti))

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Të krijohet një sistem vlerësimi (të paktën 6 dimensione analize, me një total prej të paktën 50 variablash) për të demonstruar nivelin e gadishmërisë për investime (IRL) të Bashkive të vogla rurale, duke rritur kështu atraktivitetin e tyre për investitorët. Sistemi i vlerësimit do të tregojë gjithashtu zgjidhje shumëqeverisëse për të adresuar sfidat sociale dhe demografike, për të përmirësuar treguesin IRL. Kjo do të bëhet përmes veprimeve pilot që demonstrojnë aftësinë e tyre për të ndikuar në tregues.

Nuk ka (ende) një vlerësim të standardizuar të Nivelit të Gadishmërisë për Investime (IRL) për komunat e vogla rurale dhe malore, por ekzistojnë mjete sektoriale, tregues të përbërë dhe praktika të mira që mund të shërbejnë si bazë për ndërtimin e një të tille. Një bashki e vogël që është transparente, kompetente, angazhuese dhe ka një narrativë të qartë ndaj investitorëve potencialë:

- zvogëlon asimetrinë e informacionit
- zvogëlon rrezikun e perceptuar
- rrit besimin dhe reputacionin

REZULTATET KRYESORE
- Sistemi i Vlerësimit të Nivelit të Gadishmërisë për Investime
- Zgjidhje konkrete për të rritur treguesit e vlerësimit
- Rrjeti i bashkëpunimit për të rritur bashkëpunimin IPA-ERDF dhe për të zvogëluar hendekun midis zonave ne zhvillim

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Fondet ne dispozicion te projektit do te afrohen nga Bashkimi Evropian

Drejtoria / Sektori përgjegjës
Sektori i integrimit Evropian dhe diaspores

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

familjet vulnerabel

A është objekt i konsultimit publik:

JO

Komisioni i Përhershëm për integrimin europian , i mbledhur me datën 20/06/2025, shqyrtoi projekt vendimit, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për " Marreveshjen e bashkepunimit per zbatimin e projektit: - "treguesi i komunitetit per invesrime ne vlere dhe kapacitete te inovacionit ", ne kuader te Programit: "ADRION INTERREG ", financuar nga Bashkimi Evropian paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njeren)
   a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
   b) **miratimin e projektaktit**
   c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

1. pa ndryshime

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

_____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

_____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Armida Kastrati anëtar.